



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E BUJQESISË  
DHE ZHVILLIMIT RURAL

# PLANI I INTEGRITETIT

PËR  
MINISTRINË E BUJQESISË  
DHE ZHVILLIMIT RURAL

2024–2027

Miratuar me Urdhrin Nr. 568 , datë 25.7.2024, të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Znj. Elona Gjata,

Drejtor, Drejtues i Grupit të Punës

**Grupi i Punës, anëtarë:**

- a) Z. Lavdrim Sahita, Sekretar i Përgjithshëm;
- b) Z. Irfan Tarelli, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- c) Z. Martin Mici, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit;
- ç) Z. Bledi Mile, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural;
- d) Z. Altin Pasko, Drejtor, Drejtoria e Auditimit;
- dh) Znj. Eranda Selmanaj, Drejtor, Drejtoria e Programimit dhe Monitorimit të IPARD;
- e) Znj. Ela Miziri, Drejtor, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme;
- ë) Znj. Lindita Gjokazaj, Përfaqësues i Njësisë së Sinjalizimit;
- f) Znj. Eneida Sokoli, Sektori i Buxhetit (edhe sekretariat);
- g) Znj. Elda Tahiraj, Sektori i Përpunimit, Monitorimit të të Dhënave dhe Statistikave;
- gi) Znj. Elsa Vorfi, Përfaqësues për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;
- h) Znj. Arlinda Dedi, Koordinator për të Drejtën e Informimit;
- i) Znj. Kjara Vogli, Koordinator për Konsultimin Publik.

*Plani i Integritetit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është hartuar në përpunje me Rekomandimin Nr. 2, të Raundit V të Vlerësimit “Parandalimi i korruptionit dhe promovimi i integritetit në qeverinë qendrore (funkcionet e larta ekzekutive) dhe agjencitë e zbatimit të ligjit” të GRECO, për përfshirjen e masave për funksionarët politikë të kabinetit pranë ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.*

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

|   |           |
|---|-----------|
| <b>LISTA E SHKURTESAVE.....</b>   | <b>4</b>  |
| <b>I. PLANI I INTEGRITETIT .....</b>  | <b>5</b>  |
| <b>I.1 Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit .....</b>   | <b>5</b>  |
| I.1.1 Ngritura e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit dhe mobilizimi i stafit të ministrisë.....   | 5         |
| I.1.2 Identifikimi dhe analiza e riskut .....   | 5         |
| I.1.3 Vlerësimi i risqeve të integritetit.....  | 6         |
| I.1.4 Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut.....   | 6         |
| <b>I.2 Qasja metodologjike.....</b>   | <b>6</b>  |
| <b>I.3 Përbajtja e Planit të Integritetit.....</b>  | <b>7</b>  |
| <b>II. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT.....</b>   | <b>8</b>  |
| <b>II.1 Objektivi Strategjik I: Hartimi, monitorimi, vlerësimi i Programit IPARD dhe raportimi mbi zbatimin e tij.....</b>  | <b>9</b>  |
| <b>II.2 Objektivi Strategjik II: Përmirësimi i sistemit të planifikimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët zhvillimorë me qëllim rehabilitimin dhe modernizimin e infrastrukturës së ujites, kullimit, mbrojtjes nga përmbytja dhe sigurinë e digave .....</b> | <b>10</b> |
| <b>II.3 Objektivi Strategjik III: Garantimi i kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të aktiveve nga struktura përkatëse .....</b>   | <b>11</b> |
| <b>II.4 Objektivi Strategjik IV: Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Ministri.....</b>  | <b>11</b> |
| <b>II.5 Objektivi Strategjik V: Sigurimi i burimeve financiare për kryerjen e operacioneve/veprimtarisë, planifikimi dhe administrimi i buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët për rritjen e financimeve të huaja .....</b>   | <b>12</b> |
| <b>III. PLANI I VEPRIMIT .....</b>  | <b>13</b> |
| <b>III.1 Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit .....</b>  | <b>13</b> |

## **LISTA E SHKURTESAVE**

|       |   |
|-------|---|
| GRECO | Grupi i Shteteve Kundër Korruptionit            |
| MBZHR | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural      |
| MF    | Ministria e Financave                           |
| MVRI  | Metodologja e Vlerësimit dhe Riskut             |
| PSV   | Procedura Standarde Veprimi                     |
| QTTB  | Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore |
| VKM   | Vendim i Këshillit të Ministrave                |

## I. PLANI I INTEGRITETIT

Plani i Integritetit për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) u hartua gjatë periudhës nëntor 2023 – dhjetor 2023. Ky plan është hartuar duke u mbështetur në dokumentin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Qeverisjen Qendrore (MVRI) dhe gjithashtu në përputhje me Dokumentin Manual të Vlerësimit të Riskut të Integritetit.

### 1.1 Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Menaxhimi i riskut të integritetit në MBZHR përfshin zbatimin e 6 fazave të cilat janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, dhe që detajohen më poshtë:

1. Vendosja e objektivave;
2. Identifikimi i risqeve;
3. Vlerësimi i risqeve;
4. Trajtimi i risqeve;
5. Plani i veprimit për menaxhimin e riskut dhe regjistri i riskut;
6. Monitorimi dhe raportimi.

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme:

#### 1.1.1 Ngrija e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit dhe mobilizimi i stafit të Ministrisë

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ngriji grupin e punës për vlerësimin e riskut të integritetit dhe përgatitjen e planit të integritetit të MBZHR-së (Urdhër Nr. 496, datë 27.6.2024) ku në përbërje të grupit të punës janë punonjës të nivelit drejtues, i cili u kryesua nga drejtori në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike Administrative, i cili siguroi mbarëvajtjen e procesit dhe koordinimin e aktiviteteve në institucion. Grupi i Punës u asistua nga një sekretariat teknik, i përbërë nga një anëtar, me qëllim lehtësimin dhe ndjekjen e proceseve të vlerësimit të riskut të integritetit dhe hartimin e Planit të Integritetit të institucionit.

#### 1.1.2 Identifikimi dhe analiza e riskut

Gjatë kësaj faze, Grupi i Punës i kushtoi vëmendje të veçantë analizës së kuadrit ligjor dhe atij të brendshëm rregulator për veprimtarinë e institucionit. Kjo fazë përshtiu dhe analizën e raporteve të ndryshme të MBZHR-së mbi veprimtarinë e saj por dhe të jashtme mbi çështje që lidhen me fushat e veprimtarisë së institucionit. Grupi i punës vijoi me identifikimin (përshkrimin) dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për procesin e punës në fushat funksionale të institucionit si dhe veprimet për të adresuar boshllëqet.

### **1.1.3 Vlerësimi i risqeve të integritetit**

Gjatë kësaj faze, Grupi i Punës identifikoi dhe analizoi faktorët e riskut që mund të pritet të mbështesin ose risin risqe të tilla. Gjatë kësaj faze të procesit u krye edhe një analizë për fushat e veprimtarisë që kërkonin vlerësim më të detajuar për shkak të ekspozimit të tyre më të madh ndaj risqeve të integritetit. Në vijim risqet e vlerësuara dhe faktorët e tyre u renditen sipas perparësise. Procesi vijoi me vlerësimin e efektivitetit të masave ekzistuese të kontrollit apo kontolleve shtesë në institucion për risqet e vlerësuara dhe me propozimin e masave të reja për trajtimin e tyre.

### **1.1.4 Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut**

Grupi i punës hartozi planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion, në të cilin u evidentua: rishku, kontrolllet e ndërmarra, veprimet për të adresuar boshllëqet, zotëruesi i riskut dhe përfshiu masa të reja kontrolli apo përmirësimin e masave ekzistuese. Masat pershkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitet organizative për zbatimin e tyre.

## **1.2 Qasja metodologjike**

Metodologjia është e mbështetur në disa parime kryesore, zbatimi i të cilave ndikon në parandalimin e shkeljeve që cënojnë integritetin e institucionit. Këto parime përfshijnë:

- Minimizimin e pushtetit diskrecional të tepërt dhe të panevojshëm që zotërojnë autoritetet ekzekutive, administrata apo organet/strukturat në marrjen e një vendimi, dhe/ose qartësimin e përcaktimit të kritereve, procedurave dhe standardeve për procesin e vendimmarrjes;
- Rritjen e transparencës dhe llogaridhënieve publike në punën e institucionit, gjë që minimizon risqet që dëmtojnë integritetin e institucionit dhe është garanci për zbatimin e parimit të ligjshmërisë;
- Forcimin e mekanizmave të kontrollit për institucionin. Në parim, çdo veprim i autoritetit publik duhet të jetë objekt kontrolli për të ruajtur sistemin “kontrollo balancën” dhe parimin e ndarjes së pushteteve;
- Thjeshtëzimin dhe riorganizimin e procedurave të zbatuara nga autoritetet, organet apo administrata qendrore të cilat nuk përbushin qëllimin për të cilin janë miratuar dhe krijojnë mundësi për risqe integriteti.

Grupi i Punës, në procesin e hartimit të Planit të Integritetit, ka përdorur dy metoda kryesore për të analizuar dhe vlerësuar cënueshmërinë e integritetit: metoda cilësore dhe metoda sasiore. Hapi i parë ka qenë realizimi i një trajnimi dhe takimi informues me grupin e punës dhe punonjësit e ministrisë për metodologjinë e vlerësimit të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore. Këtu përfshihet edhe analiza e kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategik të ministrisë (shqyrtimi i literaturës). Gjithashtu, u analizuan raporte të ndryshme, për veprimtarinë e ministrisë të hartuara nga institucione kombëtare, ndërkombëtare apo organizata të ndryshme.

Më pas u analizuan të dhënat që u përfuan nga diskutimet në fokus grupe me stafin e ministrisë. Këto diskutime shërbyen për të identifikuar aspektet negative në realizimin e proceseve të punës, praktikave të punës dhe funksionet e tjera që janë të ekspozuara ndaj shkeljeve të integritetit, sjelljeve jo-etike e joprofesionale dhe parregullsive të tjera.

Metoda tjetër e përdorur ishte ajo sasiore, ku përmes vlerësimit me anë të një pyetësori të strukturuar bëhen pyetje për çështje të veçanta të integritetit dhe etikës në institucion. Kjo metodë u zbatua dhe u administrua nga MBZHR. Pyetësori është një instrument shumë i rëndësishëm për mbledhjen e të dhënavë të sakta dhe të kuantifikuara të rreziqeve të integritetit për aspekte të veçanta të integritetit në ministri. Pyetësori i vlerësimit trajton nivelin e zbatimit të ligjt, procedurat e rekrutimit, vlerësimin e performancës, zhvillimin në karrierë, komunikimin e brendshëm si dhe rolin e njësive të ministrisë. Këtij pyetësori punonjësit e ministrisë iu përgjigjën në mënyrë anonime. Kampionimi kishte një shpërndarje të gjërë për sa i përket gjinisë, moshës dhe vjetërsisë në punë. Të anketuarit meshkuj përbëjnë 29% të kampionit krahasuar me punonjëset femra që janë 71%. Punonjësit e moshës 35-45 vjeç kanë përqindjen më të madhe në kampion me 35 %. Edhe të intervistuarit në moshë 25-35 vjeç janë të përfaqësuar mirë dhe përbëjnë 23% të kampionit. Kategoria e grupmoshës mbi 45 vjeç përfaqëson 33% të kampionit, atë të moshës deri në 25 vjeç përfaqësojnë 9% të kampionit. Të anketuarit me më pak përvojë pune, më pak se 5 vjet, përfaqësojnë 11% të kampionit. Kategoria 5 -10 vite përvojë pune përfaqësojnë 32% të kampionit dhe ata me 11- 20 vjet përbëjnë 57% të kampionit.

### 1.3 Përbajtja e Planit të Integritetit

Plani i Integritetit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është një instrument i luftës kundër korruptionit, për të patur një administratë publike profesionale, me etikë, integritet dhe e angazhuar për t'iu shërbyer qytetarëve në fushën e bujqësisë, blegtorisë, peshkimit dhe të tjerë sektorë nën përgjegjësinë e MBZHR. Ky plan ka të parashikuar masa të identifikuara në 13 fusha të përgjegjësisë institucionale të ministrisë. Plani i Integritetit për vitin 2024-2027 përmban gjithsej 38 masa të karakterit rregulator e operacional, dhe për të cilat janë parashikuar ndërhyrje (aktivitete) përkundrejt çdo risku të evidentuar. Njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre janë drejtoritë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe grupe institucionale pune. Afati i zbatimit të këtij Plani Integriteti ishte deri në fund të vitit 2027 dhe kostot financiare të planit do të mbulohen nga buxheti i MBZHR-së.

Në përputhje me kreun 3, pika 3.1 të Planit të Integritetit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka hartuar këtë raport monitorimi mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente.

## **II. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT**

Qëllimi i Planit të Integritetit është vlerësimi i risqeve të integritetit të cilat komprometojnë kapacitetet e MBZHR-së për të realizuar objektivat dhe shërbimin publik në mënyrë të anshme dhe të përgjegjshme. Përmirësimi i integritetit në bujqësi ndihmon në rritjen e efikasitetit të politikave bujqësore dhe në sigurimin e qeverisjes së mirë në këtë sektor të rëndësishëm ekonomik dhe social. Në fund të fundit, një plan i integritetit në bujqësi synon të përmirësojë mbështetjen për bujqësinë dhe të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barabartë të këtij sektori në shërbim të shoqërisë dhe mjedisit.

Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre është kryer për proceset e punës sipas fushave të veprimitarisë të institucionit. Këto fusha përfshijnë:

- i) fusha e buxhetit dhe menaxhimit financiar;
- ii) fusha e mirëadministrimit të burimeve njerëzore;
- iii) fusha e kontrollit, auditimit dhe mekanizmave kundër korruptionit, transparencës;
- iv) përmirësimi i sigurisë ushqimore dhe arritjes në statet e BE-së për eksport, përmes sistemit të gjurmueshmërisë për produktet me origjinë shtazore;
- v) mbështetja e investimeve nepërmjet implementimit të programit IPARD për zhvillimin e zonave rurale, diversifikimin e ekonomisë, investimet në sektorin agro-ushqimor për përmirësimin e konkurrencës, pajtueshmërisë me standarde të BE-së dhe ruajtjen e natyrës dhe mjedisit;
- vi) planifikimit e administrimit të buxhetit të institucionit si bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët zhvillimorë me qëllim rritjen e financimeve të huaja për burimet ujore në vend;
- vii) zhvillimit të sektorit bujqësor, blegtoral, agropërpunimit, në drejtim të rritjes së prodhimit/prodhimitarës së bimëve e kafshëve, përpunimit të produkteve dhe rritjes së eficencës së tyre;
- viii) konkurrueshmerise së bujqësisë dhe industrije agro-ushqimore si dhe përmirësimi i cilësisë së jetës përmes nxitjes së shumëlojshmërisë së veprimitarive ekonomike në zonat rurale;
- ix) garantimi i sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirqenies së kafshëve dhe shëndelit të bimëve përmes adoptimit të standardeve përkatëse të BE-së në kuadrin normativ vendas;
- x) zhvillimit të kapaciteteve administrative dhe infrastrukturës fizike të nerojshme për zbatimin e këtij kuadri normativ si dhe forcimit të kontrollit zyrtar si element i rëndësishëm i sistemit të sigurisë ushqimore për të garantuar jetën dhe shëndetin e konsumatorit, shëndetin dhe mirqenien e kafshëve dhe shëndetin e bimëve;
- xi) ofrimi i paketave dhe kartave teknologjike (dhe elemente të përmirësuar) të produhuara nga QTTB-të, në dispozicion të fermerëve dhe agrobizneseve;
- xii) rritjes së impaktit të investimeve në përmirësimin e infrastrukturës së kullimit, ujitjes dhe mbrojtjes nga përblytjet;
- xiii) arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve shkresore, si dhe të informacionit e të dokumenteve elektronike.

Ky plan integritetit do të japë një kontribut të rëndësishëm edhe për arritjen e objektivave strategjike të institucionit për përmirësimin e integritetit në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, objektiva që janë si më poshtë vijon:

- Hartimi, monitorimi, vlerësimi i Programit IPARD dhe raportimi mbi zbatimin e tij.
- Përmirësimi i sistemit të planifikimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët zhvillimorë me qëllim rehabilitimin dhe modernizimin e infrastrukturës së ujites, kullimit, mbrojtjes nga përmbytja dhe sigurinë e digave.
- Garantimi i kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të aktiveve nga struktura përkatëse.
- Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Ministri.
- Sigurimi i burimeve financiare për kryerjen e operacioneve/veprimtarisë, planifikimi dhe administrimi i buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët për rritjen e financimeve të huaja.

## **II.I Objktivi Strategjik I: Hartimi, monitorimi, vlerësimi i Programit IPARD dhe raportimi mbi zbatimin e tij**

Në funksion të Vlerësimit dhe Monitorimit të Programit IPARD Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka organizuar procesin duke u bazuar në 3 nënobjektiva:

1. Akreditim i masave ekzistuese dhe realizimi i thirrjeve në kuadër të Programit IPARD III 2025-2027 nga vlerësimi i së cilës janë identifikuar risqet që kanë të bëjnë me mungesën e kontributeve të sakta dhe në kohën e duhur nga institucionet e tjera, mosrespektimin e afateve të raportimeve në DG Agri, mosrealizimin në kohë dhe në mënyrën e duhur të proceseve të punës, personelin e pamjaftueshmë për një kohë të konsiderueshme për të mbuluar proceset e rëndësishme. Ndërsa masat, njësítë përgjegjëse kanë përcaktuar si të nevojshëm, ku cilësohen si: bashkëpunimi dhe koordinimi i procesit me institucionet përkatëse, komunikimi i vazhdueshmë, ndjekja e procedurave të rekrutimit dhe komunikimi i vazhdueshmë me njësinë e burimeve njerëzore.
2. Akreditimi i masave të reja në kuadër të Programit IPARD III nga vlerësimi i së cilës janë identifikuar përsëri risqe që janë pasojë e pamjaftueshmërisë në personel dhe mungesës së kontributeve të sakta dhe në kohën e duhur të proceseve të punës, masat e duhura për t'u ndërmarrë po ashtu mbeten ato të procedurave të rekrutimit, komunikimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshmë.
3. Realizimi i vlerësimit ex-post për Programin IPARD II brenda vitit 2025, është identifikuar rizu i mosrealizimit në kohë të vlerësimit ex-post të Programit IPARD II, për këtë nënobjektiv, masat janë ngushtësish të lidhura me drejtorinë e prokurimeve lidhur me ndryshimin e regjistrat të prokurimeve, hartimin e termave të referencës, kontraktimin e fituesit, etj.

## **II.2 Objktivi Strategjik II: Përmirësimi i sistemit të planifikimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët zhvillimore me qëllim rehabilitimin dhe modernizimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmbytja dhe sigurinë e digave**

Në funksion të përmirësimit të sistemit të planifikimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimit të punës me donatorët dhe partnerët zhvillimore me qëllim rehabilitimin dhe modernizimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmbytja dhe sigurinë e digave, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka organizuar procesin duke u bazuar në 16 risqe të identifikuara:

1. Mosardhja në kohë e udhëzimeve dhe tavanave nga Ministria e Financave, për administrimin e së cilës duhet të mbahen kontakte të vazhdueshme me Ministrinë e Financave.
2. Mosmbërritja në kohë dhe me cilësi e informacionit mbi nevojat për fonde nga institucionet e varësisë, drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit, për administrimin e së cilës duhet të mbahen kontakte të vazhdueshme dhe të bëhet këshillim me stafin e drejtorive të Ujitjes dhe Kullimit për përmirësimin e cilësisë së planifikimit.
3. Mosakordimi i plotë i fondeve buxhetore të kërkuara për shpenzime operative dhe investimet, për administrimin e së cilës duhet të jetë një argumentim i plotë në aspektin teknik dhe ligjor i nevojave për fonde.
4. Zhvillime të reja lidhur me politikat e qeverisë për prioritetet e zhvillimit rajonal, etj. për administrimin e së cilës duhet të rishikohen prioritetet në funksion të politikës rajonale.
5. Mosrakordimi i fondeve të kërkuara gjatë fazës së identifikimit të projekteve, për administrimin e së cilës duhet të përshtaten prioritetet në funksion të tavanave të limituara.
6. Hartimi me një cilësi të dobët i termave të referencës, për administrimin e së cilës ka nevojë për përmiresimin dhe unifikimin e standardeve të projektimit.
7. Mospërgatitja në kohë e projekteve të zbatimit sipas termave të referencës, për administrimin e së cilës duhet të respektohen afatet e kontratave nga palët.
8. Vonesat e procedurave të prokurimit, për administrimin e së cilës duhet të ndiqen afatet e procedurave sipas legjisacionit.
9. Ndryshimet e projekt – preventivave gjatë zbatimit, për administrimin e së cilës duhet të shtohet kontrolli për securinë e projekteve dhe për zbatimin e tyre.
10. Mospërputhje e grafikut të miratuar të punimeve me kushtet klimaterike të objekteve, për administrimin e së cilës duhet të përmirësohet bashkërendimi midis drejtorive përkatëse.
11. Moskryerja e punës sipas termave të referencës dhe kushteve të kontrates nga supervizori, për administrimin e së cilës duhet të ketë më shume përgjegjshmëri dhe trajnime të specialistëve të DUK-eve lidhur me zbatimin e ligjit.
12. Mospërputhje e grafikut të punimeve me grafikun e likuidimeve, për administrimin e së cilës duhet të rishikohet grafiku i punimeve në përputhje me mundësinë e likuidimeve.
13. Mossigurimi në kohën e duhur të kontrapartit (Kosto Lokale dhe TVSh) nga Qeveria Shqiptare si dhe shlyerja e detyrimeve brenda afatave kontraktuale, për administrimin e së cilës duhet të monitorohet efektivisht shlyerja e detyrimeve ndaj kontraktorëve, rialokimi i fondeve të lira në destinacionin e nevojshëm dhe në kohën e duhur.

14. Situata të paparashikuara natyrore (përmbytje, tërmete) që afektojnë infrastrukturën e kullimit.
15. Situata të paparashikuara natyrore (përmbytje, tërmete) që ndikojnë në sigurinë e digave.
16. Situata të paparashikuara natyrore (përmbytje, tërmete) që afektojnë strukturat e mbrojtjes nga përmbytja, për administrimin e 3 risqeve të fundit (14,15,16) është e nevojshme mbikëqyrja e vazhdueshme e zonave me risk të lartë dhe të ketë rialokime shpenzime/investime në raste të nevojshme.

## **II.3 Objktivi Strategjik III: Garantimi i kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të aktiveve nga struktura përkatëse**

Në funksion të garantimi të kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të aktiveve nga struktura përkatëse, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka organizuar procesin duke u bazuar në identifikimin e riskut që ka të bëjë me sigurimin e bashëpunimit me drejoritë teknike për programimin e projektakteve, kuptueshmërinë dhe zbatimin e akteve ligjore. Për njësinë përgjegjëse është shumë e rëndësishme bashkëpunimi me drejtoritë teknike kur legislacioni është kompleks apo kur përban parashikime të fushave teknike, pasi duhet të garantonohet që këto parashikime të janë të qarta dhe të zbatueshme jo vetëm për subjektet të cilave iu drejtohen por edhe çdo qytetari të zakonshëm.

## **II.4 Objktivi Strategjik IV: Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Ministri**

Në funksion të konsolidimit të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në Ministri, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka organizuar procesin në bazë të identifikimit të 6 risqeve:

1. Mungesa e Rregullores organizative për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrat Nr. 61, datë 18.4.2024, "Për miratimin e strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural", për administrimin e së cilës duhet të zhvillohen takime mes nivele të larta dhe të mesme drejtuese.
2. Vakanca në MBZHR, për administrimin e së cilës duhet të plotësohet numri i vendeve vakante të aparatit.
3. Dokumenti i politikave për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, për administrimin e së cilës duhet të hartohet, miratohet dhe publikohet politika e institucionit për mbrojtjen e të dhënave personale, gjithashtu zbatimi i kësaj politike duhet të reflektohet në manualet e vendeve të punës së punonjësve.
4. Paketë e akteve (ligjore dhe nënligjore) për zbatim në ushtrimin e detyrës, për nepunësit civil/punonjësit dhe stafin politik, për administrimin e së cilës duhet të përgatitet paketa informative për ligjet dhe aktet nënligjore bazë për çdo drejtori të MBZHR-së dhe për stafin politik, e cila duhet të shpërndahet veçanërisht tek punonjësit e rinj të MBZHR-së.

5. Ruajtje e kujtesës institucionale e vijueshmëri e aktivitetit të drejtorive të MBZHR-së, për administrimin e së cilës duhet të përgatitet dhe të dorëzohen në protokoll materiali informues për çdo pjesëmarrje në trajnime dhe grupe pune dhe përfaqësime të MBZHR-së (brenda dhe jashtë vendit).
6. Përmirësim i Programit të Transparencës për institucionin e MBZHR-së, për administrimin e së cilës Koordinatori i së Drejtës së Informimit me Nëpunësin duhet të përditësojë rregullisht Programin e Transparencës.

## **II.5 Objktivi Strategjik V: Sigurimi i burimeve financiare për kryerjen e operacioneve/veprimtarisë, planifikimi dhe administrimi i buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët për rritjen e financimeve të huaja**

Në funksion të sigurimit të burimeve financiare për kryerjen e operacioneve/veprimtarisë, planifikimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimit të punës me donatorët dhe partnerët për rritjen e financimeve të huaja, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka organizuar procesin në bazë të identifikimit të 5 risqeve:

1. Mungesa e fondeve buxhetore, mosrealizim në kohë i detyrave operacionale me qëllim mirëfunkcionimin e punës në institucion, për administrimin e së cilës duhet të zhvillohen takime dhe raporte të vazhdueshme me drejtuest e institacioneve, Ministrinë e Financave, donatorët, etj. me qëllim sigurimin e fondeve. Gjithashtu, janë të nevojshme udhëzime nga MF për përmirësimin e procesit dhe marrjen e masave për sigurimin e buxhetit të nevojshëm.
2. Pamundësia e sigurimit të fondeve nëpërmjet financimit të huaj, për administrimin e së cilës duhet të zhvillohen takime me MF me qëllim rialokime të mundshme dhe korrektimin e planit.
3. Moskryerja në kohë e pagesave për të tretë në bazë të detyrimeve kontraktore për mangësi në dokumentacion, për administrimin e së cilës duhet të ketë komunikim të vazhdueshëm me drejtorinë e prokurimeve, shërbimeve mbështetëse për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për çdo pagesë.
4. Mospërgatitja në kohë e gjithë dokumenteve dhe pagesave financiare në zbatim të legjislacionit në fuqi, per nëpunësit civil/punonjësit dhe stafin politik, për administrimin e së cilës është i domosdoshëm përmirësimi i komunikimit me institucionet e varësise.
5. Moshedhja e gjithë informacionit finanziar dhe ajo e aseteve në programin përkatës, e cila mund të administrohet nëpërmejt mbledhjes së të dhënave të nevojshme, përditësimit të informacionit brenda sektorit, si dhe plotësimit të regjistrave në kohë dhe me saktësi.

### **III. PLANI I VEPRIMIT**

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integrititetit të identifikuara sipas 13 fushave të përgjegjësisë së MBZHR-së. Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integrititetit institucional. Plani ka për qëllim arritjen e objektivave për forcimin e integritetit si më poshtë:

1. Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integrititetit në MBZHR, në mënyrë që të minimizohet cënimi i tyre nga risqet e integrititetit;
2. Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për t'i rezistuar shkeljeve të integrititetit;
3. Transparenca më e latë e punës dhe e veprimtarisë së MBZHR-së brenda institucionit me aktorë të jashtëm të interesuar dhe publikun.

#### **III.I Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit**

Monitorimi është periodik (raporte 6-mujore dhe vjetore) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës, për zbatimin e masave të miratuara në Planin e Veprimit. Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë eficente, nëse kanë evidentuar ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioriteteve të risqeve (Planit të Veprimit), si edhe nxjerrjen e mësimeve për planifikim më të mirë në të ardhmen.

Raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e Planit të Integrititetit për risqet e integrititetit sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar nga titullari institucionit, i cili monitoron progresin e zbatimit. Raporti i lejon titullarit të ndërmarrë masa përmirësuese, në rast se zbatimi i ndonjë mase të caktuar ka sjellë vështirësi apo vonesa.

**Objektivi I: Hartimi, monitorimi, vlerësimi i Programit IPARD dhe raportimi mbi zbatimin e tij**

| Nr.  | Risku dhe ngjarjet e mundshme   | Kategoria e faktorëve të riskut | Intensiteti i riskut  | Masat/Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatim   | Struktura (njësia) përgjegjëse               | Afati i zbatimit         |
|--|---|---------------------------------|---|---|--|--------------------------|
|  |   |                                 | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Prioritet i lartë</li> <li>• Prioritet i moderuar</li> <li>• Prioritet i ulët</li> </ul> |   |  |                          |
| Nënobjektivi Nr.I Akreditim i masave ekzistuese dhe realizimi i thirrjeve në kuadër të Programit IPARD III 2025-2027 |   |                                 |   |   |  |                          |
| I.I  | Mungesa e kontributeve të sakta dhe në kohën e duhur nga institucionet e tjera. | Përputhshmërie Reputacionale    | I moderuar  | Bashkëpunim me institucionet përkatëse dhe komunikim i vazdueshëm.  | Drejtoria Programimit dhe Monitorimit IPARD. | 6 M-I-2024 e ne vazhdim  |
|  | Mosrespektimi i afateve të raportimeve në DG Agri                               | Përputhshmërie                  | I moderuar  | Koordinimi i procesit në bashkëpunim me institucionet e tjera. Organizimin dhe pjesëmarrje në takimet me institucionet. | Drejtoria Programimit dhe Monitorimit IPARD. | 6 M-II-2024 e ne vazhdim |

|  |  |             |            |  |   |             |
|--|--|-------------|------------|--|---|-------------|
| 1.2  | Mosrealizimi në kohë dhe në mënyrën e duhur i proceseve të punës.                              | Operacional | I moderuar | Ndjekja e procedura të rekrutimit dhe komunikimi i vazhdueshëm me Sektorin e Burimeve Njerëzore.                             | Drejtoria Programimit dhe Monitorimit IPARD Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. | 6 M-II 2024 |
|  | Personel i pamjaftueshëm për një kohë të konsiderueshme për të mbuluar proceset e rëndësishme. | Operacional | I moderuar | Ndjekja e procedura të rekrutimit dhe komunikimi i vazhdueshëm me Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë. | Drejtoria Programimit dhe Monitorimit IPARD Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. | 6 M-II 2024 |
| <b>Nënobjektivi Nr. 2 Akreditimi i masave të reja në kuadër të Programit IPARD III</b> |  |             |            |  |   |             |
| 2.1  | Mosrealizimi në kohë dhe në mënyrën e duhur i proceseve të punës.                              | Operacional | I moderuar | Ndjekja e procedura të rekrutimit dhe komunikimi i vazhdueshëm me Sektorin e Burimeve Njerëzore.                             | Drejtoria Programimit dhe Monitorimit IPARD Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. | 6 M-II 2024 |
|  | Personel i pamjaftueshëm për një kohë të konsiderueshme për të mbuluar proceset e rëndësishme. | Operacional | I moderuar | Ndjekja e procedura të rekrutimit dhe komunikimi i vazhdueshëm me Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë. | Drejtoria Programimit dhe Monitorimit IPARD Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. | 6 M-II 2024 |

|  |   |                             |            |   |  |             |
|--|---|-----------------------------|------------|---|--|-------------|
| 2.2  | Mungesa e kontributave të sakta dhe në kohën e duhur nga institucionet e tjera. | Përputhshmërie Reputacional | I moderuar | Bashkëpunim me institucionet përkatëse dhe komunikim i vazhdueshëm.   | Drejtoria Programimit dhe Monitorimit IPARD.                         | 6 M-I-2025  |
| Nënobjektivi Nr. 3 Realizimi i vlerësimit ex-post për Programin IPARD II brenda vitit 2025 |   |                             |            |   |  |             |
| 3.1  | Mosrealizimi në kohë i vlerësimit ex-post të Programit IPARD II.                | Përputhshmërie              | I lartë    | Bashkëpunim i ngushtë me Drejtorinë e Prokurimeve për ndryshimin e regjistrimit të prokurimeve, hartimin e termave të referencës, hapjen e procedurës dhe zhvillimin e saj. | Drejtoria Programimit dhe Monitorimit IPARD Drejtoria e Prokurimeve. | 6 M-II 2024 |
|  |   |                             |            | Bashkëpunim i ngushtë me Drejtorinë e Prokurimeve për kontraktimin e fituesit dhe fillimi i zbatimit të kontratës.  | Drejtoria Programimit dhe Monitorimit IPARD Drejtoria e Prokurimeve. | 6 M-I 2025  |
|  |   |                             |            | Bashkëpunimi me kontraktorin për realizimin e detyrës dhe dorëzimi në kohë i raporteve, në përpunje me ToR  | Drejtoria Programimit dhe Monitorimit IPARD.                         | 6 M-II 2025 |

**Objektivi II: Përmirësimi i sistemit të planifikimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët zhvillimorë me qëllim rehabilitimin dhe modernizimin e infrastrukturës së ujites, kullimit, mbrojtjes nga përmbytja dhe sigurinë e digave**

| Nr. | Risku dhe faktorërt e riskut  | Kategoria e faktorëve të riskut | Intensiteti i riskut | Masat/Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatim   | Struktura përgjegjëse për aktivitetet e parashikuara | Afati     |
|-----|---|---------------------------------|----------------------|---|--|-----------|
|     |   |                                 |                      |   |  |           |
|     |   |                                 |                      |   |  |           |
| 1   | Mosardhja në kohë e udhëzimeve dhe tavanave nga Ministria e Financave (MF).   | Përputhshmëri                   | I moderuar           | Mbajtja e vazdueshme e kontakteve me MF nëpërmjet mënyrave të ndryshme të komunikimit.  | Drejtoria e Administrimit të Ujërave dhe Digave.     | 2024-2027 |
| 2   | Mosmbërritja në kohë dhe me cilësi e informacionit mbi nevojat përfunduese nga institucionet e varësisë, drejtoritë e ujites dhe të kullimit. | Përputhshmëri                   | I moderuar           | Mbajtja në kontakt të vazdueshëm dhe këshillimi i stafit të drejtorive të ujites dhe të kullimit me qëllim përmiresimin e cilësisë së planifikimit. | Drejtoria e Administrimit të Ujërave dhe Digave.     | 2024-2027 |

|   |   |               |            |  |  |           |
|---|---|---------------|------------|--|--|-----------|
| 3 | Mosakordimi i plotë i fondevë buxhetore të kërkua e për shpenzime operative dhe investimet. | Financiar     | I moderuar | Argumentimi sa më i plotë teknik dhe ligjor i nevojave përfonde.     | Drejtoria e Administrimit të Ujërave dhe Digave. | 2024-2027 |
| 4 | Zhvillime të reja lidhur me politikat e qeverisë për prioritetet e zhvillimit rajonal, etj. | Përputhshmëri | I ulët     | Rishikim prioritetesh në funksion të politikës rajonale.             | Drejtoria e Administrimit të Ujërave dhe Digave. | 2024-2027 |
| 5 | Mosrakordimi i fondevë të kërkua gjatë fazës së identifikimit të projekteve.                | Financiar     | I moderuar | Përshtatja e prioriteteve në funksion të tavaneve të limituara.      | Drejtoria e Administrimit të Ujërave dhe Digave. | 2024-2027 |
| 6 | Hartimi me një cilësi të dobët i Termave të Referencës.                                     | Operacional   | I moderuar | Nevoja për përmirësimin dhe unifikimin e standardeve të projektimit. | Drejtorië e Ujites dhe të Kullimit.              | 2024-2027 |

|    |  |               |            |   |  |           |
|----|--|---------------|------------|---|--|-----------|
| 7  | Mospërgatitja në kohë e projekteve të zbatimit sipas termave të referencës.          | Operacional   | I lartë    | Respektimi i afateve nga palët sipas kontatave.                       | Drejtoritë e Ujitjes dhe të Kullimit.  | 2024-2027 |
| 8  | Vonesat e procedurave të prokurimit.   | Operacional   | I lartë    | Ndjekja e afateve të procedimit sipas legjispcionit.                  | Drejtoritë e Ujitjes dhe të Kullimit . | 2024-2027 |
| 9  | Ndryshimet e projekt – preventivave gjatë zbatimit.                                  | Përputhshmëri | I moderuar | Rritje e kontrollit për ecurinë e projekteve dhe për zbatimin e tyre. | Drejtoritë e Ujitjes dhe të Kullimit.  | 2024-2027 |
| 10 | Mospërputhje e grafikut të miratuar të punimeve me kushtet klimaterike të objekteve. | Përputhshmëri | I moderuar | Bashkërendim midis drejtorive përkatëse.                              | Drejtoritë e Ujitjes dhe të Kullimit.  | 2024-2027 |

|    |   |               |            |   |                                      |           |
|----|---|---------------|------------|---|--------------------------------------|-----------|
| 11 | Moskryerja e punës sipas Termave të Referencës dhe Kushteve të Kontratës nga supervizori.   | Përputhshmëri | I moderuar | Kritje e përgjegjshmërisë dhe trajnimeve të specialistëve DUK në zbatimin e ligjit.   | Drejtori të Ujitjes dhe të Kullimit. | 2024-2027 |
| 12 | Mospërputhje e grafikut të punimeve me grafikun e likuidimeve.  | Përputhshmëri | I moderuar | Rishikimi i grafikut të punimeve në përputhje me mundësine e likuidimeve.   | Drejtori të Ujitjes dhe të Kullimit. | 2024-2027 |
| 13 | Mossigurimi në kohën e duhur të kontrapartit (Kosto Lokale dhe TVSH) nga Qeveria Shqiptare si dhe shlyerja e detyrimeve brenda afatave kontraktuale | Përputhshmëri | I moderuar | Monitorimi i shlyerjes së detyrimeve ndaj kontraktorëve, rialokimi i fondeve të lira në destinacionin e nevojshëm dhe në kohën e duhur. | EMP (Banka Botërore).                | 2024-2027 |
| 14 | Situata të paparashikuara natyrore (përmbytje, tërmete) që afektojnë infrastrukturën e kullimit.  | Operacional   | I lartë    | Mbikëqyrje e vazhdueshme e zonave me rizik te lartë dhe rialokim shpenzim/investim në raste të nevojshme.                               | Drejtori të Ujitjes dhe të Kullimit. | 2024-2027 |

|    |   |             |         |  |  |           |
|----|---|-------------|---------|--|--|-----------|
| 15 | Situata të paparashikuara natyrore (përmbytje, tërmete) që ndokojnë në sigurinë e digave.                   | Operacional | I lartë | Mbikëqyrje e vazhdueshme e zonave me risk të lartë dhe rialokim shpenzim/investim në raste të nevojshme. | Drejtori të e Ujitjes dhe të Kullimit. | 2024-2027 |
| 16 | Situata të paparashikuara natyrore (përmbytje, tërmete) që afektojenë strukturat e mbrojtjes nga përmbytja. | Operacional | I lartë | Mbikëqyrje e vazhdueshme e zonave me risk të lartë dhe rialokim shpenzim/investim në raste të nevojshme. | Drejtori të e Ujitjes dhe të Kullimit. | 2024-2027 |

**Objektivi III: Garantimi i kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të aktiveve nga struktura përkatëse**

| Nr. | Risku dhe ngjarjet e mundshme  | Kategoria e faktorëve të riskut | Intensiteti i riskut  | Masat/Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatim   | Struktura (njësia) përgjegjëse   | Afati i zbatimit |
|-----|--|---------------------------------|---|---|--|------------------|
|     |  |                                 | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Prioritet i lartë</li> <li>• Prioritet i moderuar</li> <li>• Prioritet i ulët</li> </ul> |   |  |                  |
| I.1 | Sigurimi i bashëpunimit me drejtoritë teknike lidhur me programimin e projektakteve, kuptueshmërinë dhe zbatimin e akteve ligjore. | Përputhshmërie                  | I larte   | <p>Bashkëpunimi me drejtoritë teknike është i rëndësisë së lartë sidomos në rastet kur akti ligjor apo n/ligjor paraqitet kompleks apo përmban një sërë parashikimesh rregullatore në varësi të fushës së zbatimit.</p> <p>Për të garantuar kuptueshmërinë edhe për qytetarët e zakonshëm, për të shmangur keqkuptimet apo përdorimin e nënkuptimeve, roli i teknikut është shumë i rëndësishëm pasi në fusha e përgjegjësisë së MBZHR-së është tepër specifike si mbrojtja e bimëve, fusha e peshkimit, tokat bujqesore, veterinaria etj. Ndonjëherë, fjalët kanë kuptime të ndryshme në varësi të kontekstit rregulator të aktit ligjor ndaj bashkëpunimi me ekspertin është vendimtar jo vetëm që akti ligjor të jetë i kuptueshëm por edhe të garantonohet zbatimi sa më eficent i tij. Ky proces është i rëndësisë së lartë pasi siç u përmend më lart, tekstet e akteve ligjore/nenligjore zbatohen në praktikë nga njerëz të cilët jo detyrimisht janë nënpunës. Ndaj në këtë aspekt juristi bashkëpunon ngushtë me ekspertin që teksti i aktit ligjor të jetë jo vetëm rregullues dhe përcaktues në objektin e tij por edhe i kuptueshëm dhe praktik gjatë zbatimit të tij.</p> | Drejtoria e Programimit, Standardizmit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregulator. | Në vijim         |

**Objektivi IV: Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Ministri**

| Nr.                            | Risku dhe ngjarjet e mundshme   | Kategoria e faktorëve të riskut | Intensiteti i riskut | Masat/Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatim  | Struktura (njësia) përgjegjëse  | Afati i zbatimit |
|--------------------------------|---|---------------------------------|----------------------|--|---|------------------|
| RISIKU DHE NGJARJET E MUNDSHME |   |                                 |                      |  |   |                  |
| 1                              | Mungesa e Rregullores organizative për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrat Nr. 61, datë 18.4.2024, "Për miratimin e strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural". | Operacional                     | I mesëm              | Ndjekja e procedurës së brendshme me takime në nivel drejtore përgjithshëm dhe drejtore drejtorie. | Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike Administrative. | 2024             |
| 2                              | Vakanca në MBZHR  | Operacional                     | I mesëm              | Të plotësohet numri i vendeve vakante në aparatin e MBZHR-së.                                      | Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike Administrative. | 2024-2027        |

|   |  |             |            |  |   |                              |
|---|--|-------------|------------|--|---|------------------------------|
| 3 | Dokumenti i politikave për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.   | Operacional | I mesëm    | Hartimi, miratimi dhe publikimi i politikës së institucionit për mbrojtjen e të dhënave personale.<br>Reflektimi i zbatimit të politikës për mbrojtjen e të dhënave personale në manualet e vendeve të punës së punonjësve të institucionit. | Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike Administrative. | 6 mujori i dytë i vitit 2025 |
| 4 | Paketë e akteve (ligjore dhe nënligjore) për zbatim në ushtrimin e detyrës, për nepunësit civil/punonjësit dhe stafin politik. | Operacional | I ulët     | Përgatitje e paketës informative për ligjet dhe aktet nënligjore bazë për çdo drejtori të MBZHR dhe stafi politik.<br>Shpërndarje e paketës informative tek punonjësit e rinj të MBZHR-së.   | Të gjitha drejtoritë.   | 2024-2027                    |
| 5 | Ruajtje e kujtesës institucionale e vijueshmëri e aktivitetit të drejtorive të MBZHR-së.                                       | Operacional | I moderuar | Material informues të dorëzuara në protokoll për çdo pjesëmarrje në trajnime dhe grupe pune dhe përfaqësime të MBZHR-së (brenda dhe jashtë vendit).  | Të gjitha drejtoritë /Sektori i Arkive Protokollit.                                 | 2024-2027                    |
| 6 | Përmirësim i Programit të Transparencës për institucionin e MBZHR-së   | Operacional | I moderuar | Të përditësohet rregullisht Programi i Transparencës.  | Koordinatori i të Drejtës së Informimit me Nëpunën që do të përcaktohet.            | 6- mujori II -2024           |

**Objektivi V: Sigurimi i burimeve financiare për kryerjen e operacioneve/ veprimtarisë, planifikimi dhe administrimi i buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët për rritjen e financimeve të huaja**

| Nr. | Risku dhe ngjarjet e mundshme   | Kategoria e faktorëve të riskut | Intensiteti i riskut  | Masat/Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatim   | Struktura (njësia) përgjegjëse                           | Afati i zbatimit |
|-----|---|---------------------------------|---|---|--|------------------|
|     |   |                                 | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Prioritet i lartë</li> <li>• Prioritet i moderuar</li> <li>• Prioritet i ulët</li> </ul> |   |  |                  |
| 1   | Mungesa e fondeve buxhetore, mosrealizim në kohë i detyrave operacionale me qëllim mirëfunksionimin e punës në institucion. | Financiar                       | I lartë   | Takime dhe raportime të vazhdueshme me drejuesin e institucionit, MF, donatorët, etj. me qëllim sigurimin e fondeve. Udhëzime nga MF për përmirësimin e procesit, marrjen e masave për sigurimin e buxhetit të nevojshëm. | Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar MBZHR GMS. | 2024-2027        |
| 2   | Pamundësia e sigurimit të fondeve nëpërmjet financimit të huaj.   | Reputacional                    | I lartë   | Takime me MF me qëllim rialokime të mundshme dhe korrektimin e planit.  | Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar MBZHR GMS. | 2024-2027        |

|   |  |              |         |   |   |           |
|---|--|--------------|---------|---|---|-----------|
| 3 | Moskryerja në kohë e pagesave për të tretë në bazë të detyrimeve kontraktore për mangësi në dokumentacion. | Reputacional | I mesëm | Komunikim i vazhdueshëm me Drejtorinë e Prokurimeve, Shërbimit. Plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm për çdo pagesë.                        | Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar MBZHR SP. | 2024-2027 |
| 4 | Mospërgatitja në kohë e gjithë dokumenteve dhe pagesave financiare në zbatim të legjislacionit në fuqi.    | Financiar    | I lartë | Komunikim i vazhdueshëm me institucionet e varësisë.  | Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar MBZHR SP. | 2024-2027 |
| 5 | Moshedhja e gjithë informacionit finansiar dhe ajo e aseteve në programin përkatës.                        | Financiar    | I mesëm | Mbledhja e të dhënave të nevojshme.<br>Përditësimi i informacionit përkatës brenda sektorit.<br>Plotësimi i regjistrave në kohë dhe me saktësi. | Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar MBZHR.    | 2024-2027 |